



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË

Nr. 5287/prot.  
2

Himarë, më 17. 11. 2023

**PROJEKTVENDIM**

Nr. 44 datë 17.11/2023

**PËR:**

**“MIRATIMIN E PRIORITETEVE NE INVESTIME NE BASHKINE HIMARE 2024-2027”**

*Baza Ligjore : Ligji nr.139/2015 date 17.12.2015 “Per vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 22, pika 2, nenit 13, pika b te Ligjit nr.107/2014 “Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar dhe akteve neligjore te tij, neni 11, V.K.M-se nr.686, “Per miratimin e rregullores se Planifikimit te Territorit”; date 22.11.2017; Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Himare miratuar me Vendim te K.K.T-se nr.2 date 16.10.2017, te zbardhur si dokument me date 19.03.2018 dhe rregulloreve perkatese te ketij Plani; interesit te banoreve nga monitorimi i kerkesave te tyre gjate degjesave publike si dhe analizimi qe i eshte bere tendencave te zhvillimit turistik, bujqesor dhe jetes ne komunitet. Bazuar per sa me siper,*

**VENDOSA:**

Miratimin e: **“MIRATIMIN E PRIORITETEVE NE INVESTIME NE BASHKINE HIMARE 2024-2027”**.

**KRYETARI I BASHKISË**

  
\_\_\_\_\_  
**JORGO GORO**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË

| PRIORITETTET NE INVESTIME PER BASHKINE HIMARE 2024 - 2027 |   |                              |                     |
|---|---|------------------------------|---------------------|
| TITULLI I INVESTIMIT                                      |   | VLERA E FINANCIMIT (NE LEKE) | STATUSI I PROJEKTIT |
| <b><u>NJESIA ADMINISTRATIVE HIMARE</u></b>                |   |                              |                     |
| 1   | NDERTIMI I SHETITORES DRIMADES, PERIVOL   | 280,000,000                  | Projekt             |
| 2   | RIKONSTRUKSION I RRUGES SE KISHES PROFETI ILIA                                  | 62,956,420                   | Projekt             |
| 3   | VAZHDIM I RRUGES NGA KISHA-PERIVOL DHE SHESHI GJILEK VAZHDIM                    | 27,000,000                   | Projekt             |
| 4   | ZGJERIM I VARREZAVE TE FSHATIT VUNO   | 3'000'000                    | Projekt             |
| 5   | REHABILITIMI I LAGJES PROTOPAPE QEPARO  | 500,000,000                  | Projekt             |
| 6   | RIKONSTRUKSION RRUGES QENDER LAGJIA GJONADHE, PILUR                             | 30,000,000                   | Ide-Projekt         |
| 7   | RRUGA HIMARE-PILUR LOTI 2   | 187,488,820                  | Projekt             |
| 8   | NDERTIM I SHKALLEVE PER NE GJIMNAZ(NGA ANA E PORTIT)                            | 6,000,000                    | Ide-Projekt         |
| 9   | QENDRA E FSHATIT PALASE   | 40,000,000                   | Projekt             |
| 10  | URA PRANE VILES QEVERTARE GJILEKE- DHERMI                                       | 10,000,000                   | Ide-Projekt         |
| 11  | SISTEMIM ASFALTIM I RRUGEVE TE BRENDESHME TE VARREZAVE KONIPICE                 | 10,000,000                   | Ide-Projekt         |
| 12  | RIKONSTRUKSION I TROTUARIT DHE BARIERES NE POTAM                                | 7,000,000                    | Ide-Projekt         |
| 13  | NDRICIM I RRUGES KRYESORE SHEN MIKAL(LAGJIA 1 MAJI)                             | 10,000,000                   | Ide-Projekt         |
| 14  | RIKOSTRUKSION I RRUGES SE KISHES SE SHEN SPIRIDHONIT(VARREZA) - NE FSHATIN VUNO | 13,000,000                   | Ide-Projekt         |
| 15  | RIKONSTRUKSION I RRUGES CAKUA-LAGJIA 1 MAJI                                     | 90,000,000                   | Ide-Projekt         |
| 16  | RIKONSTRUKSION I SHKOLLES NIKO ALEKSI QEPARO                                    | 80,000,000                   | Projekt             |
| 17  | RIKOSTRUKSION I SEGMENTEVE TE MBETURA TE LAGJES STEFANEL                        | 450,000,000                  | Projekt             |
| 18  | REALIZIMI I NDRICIMIT ME LED TE FSHATIT GJILEKE                                 | 6,000,000                    | Ide-Projekt         |
| 19  | RIKONSTRUKSION I QENDRES KAMBI- HIMARE FSHAT                                    | 30,000,000                   | Ide-Projekt         |
| 20  | STACIONE AUTOBUZI PALASE-NIVICE   | 5,000,000                    | Ide-Projekt         |
| 21  | RIKUALIFIKIMI I RRUGEVE TE FSHATIT PILUR  | 200,000,000                  | Ide-Projekt         |



|    |   |                      |             |
|----|---|----------------------|-------------|
| 22 | REALIZIMI I RRJETIT TE UJRAVE TE ZEZA DHE TRAJTIMI I TYRE NE FSHATIN QEPARO                                   | 120,000,000          | Ide-Projekt |
| 23 | RIKOSTRUKSIONI I KOPSHTEVE DHE MOBILIMI I TYRE  | 40,000,000           | Ide-Projekt |
| 24 | RIPYLLEZIM I ZONAVE PYJORE DHE MBROJTJA E TOKES NGA PERENJTE DHE LUMENJTE                                     | 80,000,000           | Ide-Projekt |
| 25 | SISTEMIMI DHE REHABILITIMI I PERRENJVE: PERROI I VISHES, PERROI I KURAMIT, PERROI I BUCIT DHE PERROI I PRINOS | 688,077,131          | Projekt     |
| 26 | RIKUALIFIKIMI I RRUGEVE TE 5 FSHATRAVE: ILIAS, LUKOVE, PALASE, PIQERAS DHE SHEN VASIL                         | 125,889,471          | Projekt     |
| 27 | RRJETI I UJRAVE TE ZEZA DHE TRAJTIMI I TYRE NE LIVADH   | 500,000,000          | Ide-Projekt |
| 28 | RRJETI I UJRAVE TE ZEZA DHE TRAJTIMI I TYRE NE JALE   | 300,000,000          | Ide-Projekt |
| 29 | RRJETI I UJRAVE TE ZEZA DHE TRAJTIMI I TYRE NE JALE   | 800,000,000          | Ide-Projekt |
| 30 | RIKUALIFIKIMI URBAN NE QENDRAT HISTORIKE TE QEPARO FSHAT DHE NE KALANE E HIMARES                              | 800,000,000          | Ide-Projekt |
| 31 | NDERTIMI I QENDRES SPORTIVE AFER STADIUMIT , HIMARE   | 155,000,000          | Projekt     |
|    | <b>SHUMA 1</b>  | <b>5,653,411,842</b> |             |
|    |   |                      |             |
|    | <b><u>NJESIA ADMINISTRATIVE LUKOVE</u></b>  |                      |             |
| 32 | RIKONSTRUKSION I RRUGES IXUAR-HALIQ-PLAZH   | 240,000,000          | Projekt     |
| 33 | SHETITORJA BORSH DHE RRUGET E BY-PASS-IT PERKATES   | 1,000,000,000        | Ide-Projekt |
| 34 | MBROJTJE LUMORE DHE PYLLEZIM TE ANES SE LUMIT BORSH   | 200,000,000          | Projekt     |
| 35 | NDERTIMI I QENDRES SE TREGUT TE PRODHIMEVE BUJQESORE BORSH  | 10,000,000           | Projekt     |
| 36 | RIKUALIFIKIMI URBAN I LAGJES SE VJETER LUKOVE   | 30,000,000           | Ide-Projekt |
| 37 | RIASFALTIMI I RRUGES PIQERAS SASAJ  | 50,000,000           | Ide-Projekt |
| 38 | RIKONSTRUKSIONI I STRUKTURES PER UJITJE DHE KULLIM PIQERAS  | 136,500,000          | Ide-Projekt |
| 39 | RRUGA E PLAZHIT BUNEC, RIKONSTRUKSION   | 80,000,000           | Projekt     |
| 40 | RIKUALIFIKIM URBAN LAGJIA E VONJES BORSH  | 76,702,535           | Projekt     |
| 41 | RIKOSTRUKSION I UJESJELLSAVE TE FSHATRAVE CORRAJ DHE FTERE  | 15,000,000           | Ide-Projekt |
| 42 | REALIZIMI I RRJETIT TE UJRAVE TE ZEZA DHE TRAJTIMI I TYRE NE FSHATIN BORSH                                    | 240,000,000          | Ide-Projekt |
| 43 | RIKOSTRUKSION I RRUGES BORSH - CORRAJ   | 288,000,000          | Projekt     |
| 44 | RIKOSTRUKSION I RRUGES BORSH - FTERRE   | 674,000,000          | Projekt     |
| 45 | RIKONSTRUKSION I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATIT NIVICE  | 8,000,000            | Ide-Projekt |
| 46 | REALIZIMI I UJESJELLSIT TATZAT NIVICE   | 800,000,000          | Ide-Projekt |

|    |  |                       |             |
|----|--|-----------------------|-------------|
| 47 | RIKONSTRUKSION DHE REALIZIMI I RRJETIT TE UJERAVE TE ZEZA TE UJERAVE TE ZEZA NE LUKOVE LAGJIA GREHOT | 35,000,000            | Ide-Projekt |
|    | <b>SHUMA 2</b>   | <b>3,883,202,535</b>  |             |
|    | <b><u>NJESIA ADMINISTRATIVE HOR - VRANISHT</u></b>   |                       |             |
| 48 | RIKONSTRUKSION I RRUGES QENDER VRANISHT HORE   | 180,000,000           | Projekt     |
| 49 | RIKONSTRUKSION I RRUGES QENDER TERBAC RRUGA NACIONALE  | 317,000,000           | Projekt     |
| 50 | RIKONSTRUKSION I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATIT TERBAC   | 30,000,000            | Ide-Projekt |
| 51 | RIKONSTRUKSION I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATIT VRANISHT   | 20,000,000            | Ide-Projekt |
| 52 | RIKONSTRUKSIONI I SHESHIT VRANISHT   | 82,155,575            | Projekt     |
| 53 | RIKONSTRUKSIONI I SHESHIT KALLARAT   | 28,000,000            | Ide-Projekt |
| 54 | RIKONSTRUKSION I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATIT KUC.   | 30,000,000            | Ide-Projekt |
| 55 | RIKONSTRUKSION I RRUGEVE TE BRENDESHME TE FSHATIT BOLENE   | 15,000,000            | Ide-Projekt |
| 56 | NDRICIMI I RRUGEVE TE BRENDESHME ME LED PER FSHATRAT; KALLARAT, BOLENE, VRANISHT, TERBAC.            | 15,000,000            | Ide-Projekt |
|    | <b>SHUMA 3</b>   | <b>717,155,575</b>    |             |
|    | <b>SHUMA E PERGJITHSHME E INVESTIMEVE NE PRIORITETET</b>   | <b>10,253,769,952</b> |             |

**KRYETARI I BASHKISË**

Jorgo GORO







REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË

Nr. 5287/2 prot.

Himarë, më 17.11.2023

**PRIORITETET NE INVESTIME NE BASHKINE HIMARE 2024-2027**

(RELACION SHOQERUES)

**Bashkia Himarë ne 2024-2027**

Vizioni i zhvillimit të territorit për Bashkinë Himarë është hartuar në mënyrë organike, si rezultat i analizave të vazhdueshme të territorit, diskutimeve me qytetarët dhe takime me grupe interesi.

Programi 4-vjecar i Prioriteteve të Investimeve të Bashkisë Himare është përpiluar me synimin madhor për një zhvillim të qëndrueshëm hapësinor, ekonomik dhe mjedisor të territorit të saj për të mbështetur ekonominë lokale, për të rimëkëmbur aktivitetin dhe ndërveprimin e shoqërisë, për të mirën e përbashkët. Ky zhvillim do të arrihet duke mbrojtur burimet natyrore, s' idomos ato me rëndësi kombëtare, hapësirat publike dhe kulturën e traditën vendore të kësaj zone me qëllimin kryesor për një të ardhme sa më të qëndrueshme. Bashkia e Himarës e ndërton të ardhmen e banorëve të saj, mbi një ekonomi të shëndoshë me fokus kryesisht turizmin. Cilësia e jetesës në këto territore do të përcaktohet edhe nga menazhimi i integruar i territorit me një qeverisje transparente për të ofruar shërbime dhe infrastrukturën përkatëse të nevojshme për çdo banor të bashkisë.

Bashkia Himarë, përtej qëllimit ekonomik, synon të krijojë mjedis shoqëror të shëndetshëm nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron, ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, hapësirat publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë.

**Informacion financiar Kryesor.**

Bazuar në kuadrin ligjor, në ligjin nr 68/2017 “Për Financat e Qeverisjes Vendore”, në ligjin nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, në ligjin nr 9632/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në ligjin nr 9936/2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në ligjin nr 10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, si dhe ligje dhe akte nënligjore të tjera, Kryetari i Bashkisë me grupin e punës përpiluan programin e Prioriteteve të investimeve të bashkisë Himare 2024-2027.

Programi i Prioriteteve të investimeve të bashkisë Himare 2024-2027, ben me të mundur efektivitetin dhe produktivitetin e shërbimeve ndaj komunitetit si dhe të vizitoreve gjatë sezonit tashme të zgjatur turistik.

Burimet e financimit kryesisht janë ato që bazohen në të ardhurat e veta vjetore, financime të qeverisë qendrore nëpërmjet instrumentave të saj, Fondit Shqiptar të Zhvillimit, projekteve rajonale, ndërkufitare, programeve paralele të organizuara me fonde të BE, për të cilat stafi përket bashkisë ka përfituar një përvojë të madhe dhe frutdhënëse.

## **Orientimi i Bashkisë në Prioritetet e zgjedhura**

### **Sistemi urban**

Ky sistem përbën tërësinë e të gjitha strukturave të ndërtuara të pranishme në territor. Analiza e këtij sistemi është të na japë një vështrim të të gjithë peisazhit të ndërtuar dhe të theksojë llojshmërinë tipologjike të pranishme në zonën e territorit bashkiak. Sistemi urban i referohet tokës tashmë të zhvilluar në vendbanime urbane dhe rurale të Bashkisë Himarë. Rritja e fluksit turistik ka kontribuar edhe në zhvillimin e vendbanimeve përreth bregdetit në plazhet më të rëndësishme. Përmirësimi i këtij sistemi është një nga prioritetet e bashkisë.

### **Sistemi infrastrukturor**

Ky sistem përmban rrjetet kryesore të infrastrukturës në nivel kombëtar dhe në nivel vendor. Analiza dhe hartëzimi i këtij sistemi dëshmon për shumëllojshmërinë e gjerë të menyrave të lëvizjes dhe përshkueshmërinë e mundshme në gjithë territorin nëpërmjet pranisë së një rrjeti të shpërndarë të rrugëve të shtruara dhe të pashtuara. Sistemi infrastrukturor është ende i pa plotë, kryesisht në zonat në të cilat janë larg fluksit të lëvizjeve. Një pjesë e vogël e rrjetit rrugor është gjithashtu në gjendje jo shumë të mirë. Një pjesë e projekteve të parashikuara në këto prioritetet i përkasin infrastrukturës rrugore.

### **Sistemi bujqësor.**

Sistemi bujqësor përbëhet nga toka bujqësore që ka si veçori thelbësore të saj pjellorinë në kuadrin e klimës së favorshme të ndihmuar nga infrastruktura përkatëse si: kanalet, rezervuarët në shërbim të saj. Si pasojë e orientimit të bashkisë e Himarës në zhvillimin e ekonomisë të bazuar kryesisht në turizëm, bujqësinë dhe përpunimin bujqësor, një pjesë e mirë e projekteve të parashikuara janë në ndihmë të kësaj ekonomie e cila çelësohet si ndihmesë e parë e turizmit në zonë.

### **Sistemi natyror.**

Bashkia e Himarës përbën pjesën më natyrale të rivierës shqiptare dhe përfaqëson peisazhin më karakteristik të saj. Zona e Bashkisë Himarë karakterizohet nga një biodiversitet tokësor i pasur me një numër të madh llojesh bimë dhe shtazore dhe përbën një interes të madh shkencor, me vlera të mëdha ekonomike (bimë mjekësore, vajra, etj) si dhe ka një shumëllojshmëri të madhe të habitateve, e shoqëruar me një bimësi të një rëndësie të veçantë kombëtare. Në vijim të kësaj i është kushtuar një vend i veçantë prioritetëve të projekteve që pasurojnë dhe ndihmojnë natyrën për ta ruajtur dhe rivitalizuar.



### **Sistemi ujq.**

Kryesisht dhe nje pjese e mire e projekteve jane ato qe lidhen me ujin dhe sistemin ujq. Shtratet e ujrave ndodhen ne te gjithë hapësirën e Bashkisë Himarë dhe në zonën më të gjerë bregdetare. Gjithashtu gjithë zona kryqëzohet nga lumenj dhe përrenj në drejtim verilindje –jugperëndim që të çojnë në det. Keto lumenj dhe perrenj ne menyre te vazhdueshme kane nevoje per mimbajtje dhe sistemime ne menyre qe te kontribojne ne ndihme te ruajtjes se natyres dhe infrastrukturave te realizuara nga komuniteti.

### **Prioritetet kryesore të investimeve**

#### **Infrastuktura dhe sistemi rrugor**

##### **Qendra urbane dhe rrjeti i brendeshem rrugor.**

Ne vijim te rikualifikimit te qendrave urbane ne plan jane qendrat qe nuk jane prekur gjate viteve te kaluara. Akoma ne pak qendra fshatrash pothuaj nuk eshte nderhyre fare qe nga para viteve 90-te. Paralelisht me qendrat lind nevoja per permiresimin e rrjetit te brendeshem rrugor te zonave te banuara. Ky rrjet eshte tejet i amortizuar dhe diku nuk ekziston fare, si ne infrastrukturat mbi toke ashtu dhe ato nen toke. Gjate parashikimit per nderhyrjen ne to do te kihet kujdes qe ne fshatrat me arkitekture tradicionale dhe monumentale te ruhet dhe rivitalizohet karakteri unik i tyre. Nje pjese e projekteve jane gati dhe ne vazhdimesi do te realizohen edhe projektet te tjera duke kompletuar keshtu te gjithë arkiven e projekteve te qendrave, te gatshme per investime nga vete Bashkia ose te financuara nga burime jashte saj(buxhet shteti, FSHZH, etj)

Ne kete kuader qellimi kryesor eshte edhe shperndarja e barabarte investimeve ne kete fushe duke ruajtur keshtu nje balance zhvilluese te rendesishme per territorin.

##### **Infrastrutura lidhese rrugore.**

Kryesisht infrastrutura lidhese eshte ajo ku dy qendra ose lagje lidhen me njerat – tjetren, nje fshat me rrugen kryesore, fshatin me varezat, rrugen kryesore me nje plazh apo fshatin me nje monument natyror/kulturor. Jane nje sere rrugesh te kategorive qe permendem me siper te cilat presin te realizohen. Keto nderhyrje permiresojne shume anen funksionale te territorit dhe per kete arsye jane nje nga prioritetet kryesore te investimeve ne infrastrukture. Ne planin e pergjithshem te Bashkise Himare jane percaktuar shume mire kategorite dhe profilet e rrugeve kryesore dhe atyre sekondare duke pasur nje baze shume te mire per profilizimin dhe me pas hartimin e projekteve.

##### **Infrastrutura rrugore rurale.**

Bashkia Himare trashегоi shume rruge rurale te cilat lidhin qendrat e banuara me tokat bujqesore, lidhin qendrat e banuara me njera tjetren si dhe lidhin qendrat e banuara me zona te ndryshme

natyrore. Ky eshte nje rrjet i madh rrugeshe nje e vogel e te cilave eshte Akoma e amortizuar dhe jo e perdorshme. Nje pjese e ketyre rrugeve rurale perdoren per te lidhur ne menyre te terthorte dy qendra te banuara ose nje qender me plazhin apo dhe te tjera dhe disa prej tyre eshte menduar te kthehen ne rruge te mirfillta asfaltike pasi ka ardhur koha te behen pjese funksionale e rrjetit nacional sekondar apo tretesor. Nje pjese tjeter e ketyre rrugeve pervec atyre qe do te perdoren e ne funksionin e tyre primar te bujqesise, te tjera jane parashikuar te riparohen dhe te mirembahen dhe te jene pjese e nje sistemi rrugor te sporteve dhe aktiviteteve turistike jashte rruge, te tilla si ecje alpinistike, bicikleta apo dhe makina, motora etj. Kjo kategori e fundit do te mbeshtese shume turizmin jashte plazheve i cili sa vjen dhe eshte ne rritje.

### **Infrastuktura e furnizimit me uje te pishen dhe sistemi i grumbullim dhe trajtimit te ujrave te ndotura**

#### **Permiresimi i prurjes, shtim te kapacitetit te depove dhe realizim riparim rrjete.**

Vete natyra e gjeografike e territorit te Bashkise Himare na mundeson qe te kemi nje pasuri te madhe natyrore te burimeve ujore.. Ashtu si dhe ne vitet e kaluara prioritet ka qene dhe do te jete studimi dhe zbulimi i burimeve te shendetshme dhe me kapacitete te medha prurese qe mundesojne furnizime te qendrave me sistemin veterrjedhje. Projektet permiresuese parashikojne qe te permiresojne kapacitetin e veprave marrese dhe realizimin e ri te tyre, rivleresimin e tubacionit te transmetimit nga keto vepra marrese ne depot mbi qendrat e banuara, shtimi, riparimi apo berja e depove te reja si dhe riparimi apo realizimi i gjithë i ri i rrjeteve brenda qendrave te banuara. Pavaresisht realizimit te veprave te reja furnizuese, vemendje te vecante do ti kushtohet riparimit dhe mirembjatjes se atyre ekzistuese si nje alternative e mire ndihmese.

#### **Permiresimi i rrjeteve ekzistues, realizimi i atyre te reja dhe realizimi i impianteve te pastrimit te ujrave te ndotura.**

Ne shume fshatra grumbullimi i ketyre ujrave behet me ane te gropave septike te cilat nuk jane realizuar ne kushtet teknike te duhura dhe per me teper mungon sherbimi me ane te automjeteve te dedikuara per terheqjen e tyre. Ne ato qendra qe ekziston pjeserisht rrjeti i grumbullimit te ketyre ujrave shkarkimi final i tyre behet ne natyre duke e kontaminuar rende kete te fundit. Projektet qe parashikohen te realizohen ne kete periudhe konsistojne ne realizimin nga e para e te gjithë rrjeteve te brendshem te grumbullimi te ujrave te zeza, realizimin e kolektoreve kryesore grumbullues dhe ne fund realizimin e veprave te gumbullimit dhe impianteve te pastrimit te cilat do te pastrojne ujin e ndotur ne nivele te tilla qe te mund te shkarkohet ne natyre pa e demtuar ate ose mund e riciklohet dhe te perdoret per vaditje apo si uje industrial nese do te kete kerkesa. Ne qendrat e vogla te banuara ku grumbullimi i banoreve eshte me i paket eshte parashikuar te realizohet rrjeti i brendshem dhe realizimi fillimisht i gropave septike te perbasketa sipas standarteve ku parashikohet mundesia e marrjes se tyre me automjete te dedikuara dhe dergimi i tyre prane impianteve te pastrimit ne qendrat e medha me perspective realizimin e impianteve te vogla perkatese prane cdo qendre apo fshati.



### **Rikonstruksione dhe mirembajtje shkolla te ciklit te ulet, te mesem dhe kopshte.**

Disa nga shkollat qe ka nen admistrim Bashkia Himare ne vitet e fundit i jane nenshtuar rikonstruksioneve te plota apo te pjesshme si dhe nje mirembajtje konstante te parashikuar vjetore te afta per te permbushur standartet e kerkuara per realizimin e mesimdhenies. Bashkia Himare si organ i azhornuar ne vazhdimesi me evolimin e sistemit arsimor ka percaktuar per te ardhmen prioritetet e saj ne nderhyrjen e permiresimit fizik dhe funksional per ambientet arsimore ne territorin e saj. Parashikohet te realizohen rikonstruksione te shkollave te cilat jane ne funksion si dhe shtim kapaciteti ne rastet kur eshte pare e nevojshme. Ne rikonstruksione do te merret parasysh edhe sistemi i ngrohjes per te gjitha ambientet duke e zgjidhur perfundimisht ate dhe hequr dore nga menytrat alternative te ngrohjes te perdorura deri tani. Paralelisht jane perfshire ne keto rikonstruksione edhe siperfaqet sportive te brendeshme apo te jashteme si pjese funksionale e mesimdhenies ne keto ambiente.

### **Vepra vaditese – kanale, rezervuare, lera dhe prita**

Veprat vaditese dhe kapacitetet e tyre u jore dhe trajtimi i tyre eshte nje pjese e rendesishme e parashikuar ne nderhyrjet per permiresin te ketyre kater viteve. Keto vepra te trasheguara nga e kaluara jane nje mbeshtetje shume e madhe per aktivitetet agro-blektorale ne territorin qe mbulon Bashkia Himare, sidomos ne zonat e thella. Aktivitetet agro-blektorale konsiderohen te rendesishme per te ardhmen e zonave ku ato kane perparesi, dhe paralelisht me investimet ne zhvillimin e turizmim ne bregdet ato do te kene nje trajtim te kujdesshem dhe te koordinuar mire me kerkesat ne rritje te kesaj fushe duke parashikuar edhe zhvillimin e turizmit rural apo agro-turizmit. Theksi eshte parashikuar te vihet per anen blektorale ne bagetine e imet dhe strukturen ndihmese qe ajo kerkon por edhe zonat ku eshte e zhvilluar frutikultura dhe sidomos zona me plantacione ulliri apo dhe zonat e pasura me bime medicinale te cilat konsiderohen te vecanta nga perberja dhe cilesia e tyre. Kanalet vaditese kerkojne ne vazhdimesi nje kujdes te vecante mirembajtjeje pasi ato jane realizuar para shume vjetesh dhe jane tejet te amortizuara. Ne projektet e parashikuara per nderhyrje, segmente te caktuara te ketyre kanaleve jane parashikuar te behen nga e para dhe gjithashtu kujdes te vecante i eshte kushtuar edhe riaktivizimit te veprave te tyre marrese si dhe pikave te shperndarjes se ujit ne parcela duke permiresuar rrjetin perkates. Nder veprat te cilat jane te trasheguara dhe qe duhen rruajtur edhe ne te ardhme jane rezervuaret dhe lerat te cilat ndihmojne ndjeshem ne agro-blektori paralelisht me burimet apo te tjera kapacitete u jore ne zone. Per to eshte parashikuar mirembajtja e bazeneve, izolimi i tyre me qellim ruajtjen e sasive u jore dhe njekohesisht rihapja e rrugeve te rekeve apo perenjeve te perkohshem qe furnizojne ato. Riparimi dhe pastrimi i pritave ne lumenj dhe perenj eshte e nje rendesie te vecante, pasi kujdesi per ato parandalon demtime nga perhapje te shpejta dhe te vrullshme te ujrave me karakter te perkohshem te cilat mund te demtojne edhe qendra te banuara pervec shkaterimeve qe mund te sjelli ne tokat bujqesore dhe bageti.

### **Mirembajtje e varrezave**

Varrezat dhe ambientet funksionale te tyre jane me rendesi shpirtore dhe memoriale per komunitetin e Bashkise Himare. Per per kete arsye ne prioritetet e viteve te ardhshme jane parashikuar nje sere nderhyrjesh dhe permiresimesh ne kete kuader, si riparimi i rrethimeve ekzistuese per ruajtjen e varreve nga kafshet dhe demtime te tjera, pastrimi i varreve dhe ambjenteve te tjera prane tyre nga bimesia, mirembajtja dhe rregullimi i rrugicave dhe infrastruktures se brendeshme, riparimi apo zevendesimi i dyerve kryesore te varezeve, rivitalizimi i gjelberimit apo mbjelljeve te reja per arsye te rritjes estetike te pejsazhit ne kete ambient. Ne raste te caktuara eshte parashikuar shtim i siperfaqes se varrezave ne harmoni me terenin dhe duke ruajtur natyren e njejte me ate ekzistuese si dhe duke u bazuar ne ligjin per sherbimin publik te varrimit.

### **Ndricimi i ambjenteve publike dhe atij rrugor**

Ndricimi i ambjenteve dhe i rrugeve merr nje kujdes te vecante si ne aspektin funksional-dekorativ ashtu edhe ekonomik. Duke qene se bashkia Himare perbehet nga shume qendra te cilat variojne nga ato turistike te plazheve, qyteti, fshatrave tradicionale historik monumental ashtu dhe qendrave rurale, si rrjedhoje menytrat dhe llojet e ndricimeve te tyre jane te ndryshme. Sipas karakteristikeve te ndricimeve dhe ndricuesve perkates eshte pasur parasysh efekti ekonomik i teknologjise se perdorur per te pasur sa me shume reduktim te energjise dhe si rrjedhoje edhe me pak kosto, duke qene se energjia qe vjen nga konsumimi i ndricuesve ne territorin tone krijon nje kosto te larte vjetore per Bashkine Himare. Per kete arsye duke u bazuar edhe ne disa segmente pilote te realizuara me pare edhe me ndihmen e donatoreve te cilat kane ulur ndjeshmerisht koston dhe harxhimin, kemi parashikuar programin e zevendesimit te llambave te zakonshme me filament me llamba LED duke percaktuar kriteret e teknologjise bashkekohore te rezistences ne kohe, konsumit te paket por edhe fluksit te pershtatshem te drites. Parashikohen te ruhen strukturat ekzistuese dhe te zevendesohen vetem kokat e ndricuesve. Ne projekt eshte parashikuar qe ne menyre spirale te nderhyet ne ndricim fillimisht ne qendrat e fshatrave dhe pastaj ne drejtim te periferise per permiresimin e ndricimit ekzistues dhe aty ku elementet ndricues jane me te dendur. Natyrisht qe do te koordinohet ngushte me projektet infrastrukturore te rrugeve qe kane nevojte per ndricim po edhe rrjeteve rrugore brenda fshtrave. Eshte pasur parasysh qe elementet struktural vertical te ndricuesve ne te adhmen te krijojne lehtesira ne menyre qe te jene te pershtatshme me teknologjite e reja ose te kene disa menyra furnizimi me energji si ne rastin e mikro paneleve fotovoltaike te montuar ne menyre harmonike me elementet e tjere te ndricimit dhe qe ne menyre akumulative ruajne energjine diellore per te kthyer ate ne dricim nate dhe me kosto shume te ulet. Menyra e shfrytezimit te rezeve diellore parashikohet qe te trajtohet si projekt pilot ne disa segmente rrugore apo shetitore anes detit. Per ceshtjen e ndricimit publik do te paraqesim prane kshillit per miratim dhe nje plane te vecant menaxhimi.



## **Mirembajtje- amjente sportive, vendstrehimeve, sistemimi i parkimene publike ne plazhe dhe sinjalistika**


### **Ambjentet sportive**

Bashkia Himare ka te trasheguar disa ambjente sportive te cilat ne vazhdimesi kane nevoje per mirembajtje. Keto ambjente sportive jane vecuara sic eshte rasti Fushes se Sportit por edhe te bashkangjitura shkollave ku keto kane edhe perdorim te dyfishte nga nxenesit dhe nga komniteti. Keto ambiente sportive perdoren edhe nga pushuesit gjate sezonit turistik duke krijuar aktivite te ndryshme sportive te organizuara dhe individuale. Mirembajtja e tyre konsiston ne riparimin apo zevendesimin e elemente dhe aksesore sportive qe jane te montuar ne keto ambiente, riparime te terenit, shtresave te ndryshme, bordurave kufizuese, vijezimet, lysterjet, rrethimet apo dhe vendosje te elementeve te rinj bashkekohor. Mirembajtja e ketyre ambjenteve i vjen ne ndihme edhe disa ekipeve sportive te profileve te ndryshme qe pergatiten dhe perfaqesojne bashkine tone ne kampionate apo aktivite zyrtare.

### **Sinjalistika ne rrugje, ne parkime, ne plazhe dhe tabela informuese**

Pervec rrugëve kryesore dhe dytesore nacionale, ne te gjitha rruget e tjera, sheshe, plazhe, parkime etj, eshte detyre e Bashkise Himare te plotesoje me sinjalistike sipas standarteve te percaktuara me ligj. Rruget e brendeshme te qytetit dhe te gjitha qendrave te tjera te bashkise jane te paisura pjeserisht ose nuk ekziston fare sinjalistika rrugore. Per kete arsye eshte parashikuar riparimi i elementeve te sinjalistikes dhe vendosja e atyre te reja. Ky process kryesisht realizohet ne bashkepunim te afert me Policine e Shtetit per te realizuar nje funksion sa me te mire te zonave te banuara. Tabelat informuese dhe orientuse jane pjese e rendesishme e rrjetit te sinjalistikes brenda territorit tone. Informacioni nga ato jepet edhe per tu orientuar brenda nje plazhi te caktuar si ne rastin e vendarkimeve ne plazh, zonat e plazheve publike, plazhe te lejushme apo te rezikshme per larje etj. Ne kete projekt mirembajtje eshte parashikuar edhe sinjalistika e shtrire apo ajo horizontale e cila realizohet me boje apo duke montuar elemente te prodhuar enkas.

**KRYETARI I BASHKISË**



**Jorgo GORO**

